

TEMA PËR TITULLIN
MASTER NË SOCIOLOGJI

NGA

DONJETA BEHRAMI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

EKSPOZE E TEMËS SË DIPLOMËS

PRISHTINË
DHJETOR, 2021

GJUHA TRUPORE NË KOMUNIKIMET SOCIALE DHE KUPTIMI I GJESTIKULACIONEVE

Marrëdhëniet njerëzore shtrijnë kuptimin e tyre në format e ndryshme komunikuese, që njerëzit përdorin për të kuptuar mesazhet dhe mendimet e njëri tjetrit. Padyshim se komunikimi verbal, është karakteristikë e monopolizuar nga njeriu, si e vetmja qenie nga të gjitha qeniet e gjalla, që përdorë gjuhën për të shprehur mendimet e veta kundrejt botës që e rrethon. Por qëllimi i kësaj teme është të shkojë përtej këtij “monopoli”. Qëllimi i këtij hulumtimi është të vë në pah anën tjetër të medaljes, që në fakt jep më tepër material. Pikërisht për faktin se njeriu në përqindjen më të madhe të komunikimit jepet me ekspresivitetin e gjestikulacioneve që përdorë gjatë atij komunikimi, dhe që në shumicën e rasteve kuptimi i atyre gjesteve na shpie më lehtë deri tek hulumtimi i vërtetësisë së fjalëve të shprehura.

Jetomë në epokën e komunikimit masiv dhe thuajse e gjithë vëmendja i jepet komunikimit njerëzor nëpërmjet aparateve teknologjike. Në kohët e sotme duket se gjuhës së trupit dhe simbolikës që ajo përçon i kushtohet më pak rëndësi se që duhet. Në këtë kuptim i jepet pak rëndësi komunikimit dhe mesazheve që transmeton mbi 90% e komunikimit njerëzor. Komunikim ky i cili ekziston aq sa edhe njeriu si qenie. Me afër 58% njeriu komunikon me anë të gjestikulacioneve. Dhe diku rreth 38% bën pjesë tonaliteti i zërit. Komunikimi joverbal, në këtë rast komunikimi me anë të gjuhës trupore tregon ca gjeste universale që natyra njerëzore i ka instiktive në momente emocionale, pra gjestikulacione që lidhen me psiken e njeriut. Por ajo çfarë vlen të theksohet më së shumti janë gjestikulacionet që tregojnë formimet kulturore. Pra ekzistojnë gjeste të njëjta, që kanë kuptime të ndryshme në shoqëri të ndryshme.

Mentori: Prof.Dr. Sabri Kiçmari

Punimi i Masterit me titull: **“Gjuha trupore në komunikimet sociale dhe kuptimi i gjestikulacioneve”** përmban gjithsejt 5 kapituj të cilët përfshijnë këto tema:

1. Kapitulli i parë- Hyrja

Në këtë pjesë është pasqyruar në mënyrë të përgjithshme komunikimi joverbal. Historiku i zhvillimit të komunikimit si dhe përqindja e komunikimit me anë të gjuhës së trupit.

2. Kapitulli i dytë- Përkufizime

Në këtë kapitull fokusi kanë qenë përkufizime nga autorë të ndryshëm për gjuhën e trupit. Poashtu ky kapitull përfshinë edhe veçoritë kryesore të komunikimit me anë të gjuhës trupore, si dhe elementet kryesore të gjuhës së trupit.

3. Kapitulli i tretë- Gjestikulacione që tregojnë gjendje psikologjike

Kapitulli i tretë i është dedikuar gjestikulacioneve të cilat tregojnë gjendje psikologjike. Pra ky kapitull nxjerr në pah anën psikologjike të rrjedhjes së komunikimit tonë të përditshëm.

4. Kapitulli i katërt- Kultura si faktor i komunikimit joverbal

Kapitulli i katërt i temës trajton gjestikulacione të caktuara të cilat kanë kuptime të ndryshme në kultura të ndryshme. Poashtu në këtë kapitull gjejmë krahasime të kulturave tjera me kulturën tonë, në aspektin e përdorimit simbolik të disa gjestikulacioneve.

5. Kapitulli i pestë- Përfundimi

Kapitulli i pestë pra Përfundimi, përfshinë një rrumbullaksim të gjithë temës. Si dhe disa rekomandime që duken si të nevojshme në lidhje me këtë temë.